

UDC 341.78

Mersel Bilalli, PhD⁴⁰⁷

MISIONET DIPLOMATIKE SPECIALE

СПЕЦИЈАЛНИТЕ ДИПЛОМАТСКИ МИСИИ

SPECIAL DIPLOMATIC MISSIONS

Abstract

Special Diplomatic Missions means diplomatic representation of one state to another state, or to one state to one international organization and conversely, but who missions usually do not last for a long time. Special Mission is a temporary journey that sends one state to another state or to headquarters of one international organization, for the purpose of considering an issue or a particular problem and possibly solving the issue through talks. Special Mission is the journey in any international conference or meeting without distinction level.

To the special missions should be a distinction between bilateral and multilateral missions. According to diplomatic law, a state may send a special mission to another country only with the consent of that state. But the multilateral mission, so if the special mission of a state is related to the participation of that state's delegation to an international conference (special mission multilateral), then regardless of interstate relations between the state where such a meeting is held and the receiving state, principle can not be excluded delegation travel, participation and enjoyment of all the facilities, privileges and immunities belonging to the holding of the

⁴⁰⁷ Profesor i rregullt në Universitetin e parë privat FON.

conference delegation. So, even though these two countries have not diplomatic relations at all each other or have the same detached, while in the territory of one state held an international conference or a meeting at the headquarters of an international organization which is located in the territory of that state, then no matter the relationship between these two countries, the delegation of the State concerned has the right to take part in meetings with all the privileges and immunities provided for these delegations.

Abstrakti

Misionet speciale diplomatike kanë karakter të përfaqësimit diplomatik të një shteti në shtetin tjetër, apo të një shteti në ndonjë organizatë ndërkombëtare dhe anasjellë, por të cilët misione zakonisht nuk zgjasin shumë gjatë. Mision special është udhëtim i përkohshme të cilët një shtet i dërgon në një shtet tjetër apo në përfaqësinë e një organizate ndërkombëtare, me qëllim të shqyrtimit të një çështje apo një problemi të caktuar dhe mundësisht të zgjidhjes së asaj çështje përmes bisedimeve. Mision special është edhe udhëtimi në ndonjë konferencë apo takim ndërkombëtar pa dallim nivelin.

Te misionet speciale duhet bërë dallimin në mes misioneve bilateral dhe atyre multilateral. Sipas të drejtës diplomatike, një shtet mund të dërgojë mision speciale në shtetin tjetër vetëm me pëlqim e atij shteti. Kurse te misioni multilateral, pra nëse misioni special i një shteti ka të bëjë me pjesëmarrjen e delegacionit të atij shteti në një konferencë ndërkombëtare (misioni special multilateral), atëherë pa marrë parasysh marrëdhëniet ndërshtetërore në mes shtetit ku mbahet një takim i tillë dhe shtetit dërgues, parimisht delegacionit nuk mund t'i ndalohej udhëtimi, pjesëmarrja dhe gëzimi i të gjitha lehtësimeve, privilegjeve dhe imunitete që i takojnë delegacionit gjatë mbajtjes së konferencës. Pra, madje sikur këta dy shtete të mos kenë aspak marrëdhënie diplomatike në mes veti apo të njëjtat i kanë të shkëputura, kurse në territorin e njërit shtet mbahet ndonjë konferencë ndërkombëtare apo ndonjë takim në selinë e një

organizate ndërkombëtare e cila gjendet në territorin e atij shteti, atëherë pa marrë parasysh marrëdhëniet në mes këtyre dy shteteve, delegacioni i shtetit në fjalë ka të drejtë të merr pjesë në takime me të gjitha privilegjet dhe imunitetet e parapara për këto delegacione.

Pa dilemë se edhe anëtarët e misionit special diplomatik gëzojnë imunitet të plotë diplomatik konform normave të së drejtës ndërkombëtare. Ata gëzojnë imunitet penal, civil, policor, administrativ dhe fiskal. Pra, ata nuk mund të arrestohen, burgosen apo të mbahen dhe ndalohen para organeve policore e gjyqësore të shtetit vendas, pa marrë parasysh se çfarë vepre penale mund të kenë kryer. Në këso rastesh veprimi më i ashpër i shtetit pranues mund të jetë shpallja e kryesit *persona non grata* dhe kërkesa që brenda një afati sa më të shkurtër apo të fiksuar anëtari i delegacionit të misionit special diplomatik ta lëshon territorin e shtetit pranues. Anëtari i misionit special diplomatik nuk ka të drejtë që vullnetarisht të heq dorë nga imuniteti penal, pra ai nuk ka të drejtë që vullnetarisht të heq dorë nga ky lloj imuniteti dhe të paraqitet para organeve kompetente penale të shtetit vendës. Por, kjo nuk vlen edhe për imunitetin civil.

Çështjen e statusit juridik ndërkombëtar të misioneve speciale e rregullon *Konventa për misionet speciale* e viti 1969. Pjesë e materies rregullohet edhe me *Konventën e Vjenës për përfaqësimin e shteteve në marrëdhëniet e tyre me organizatat ndërkombëtare me karakter universal* (1975). Delegacioni duhet të jetë në numër të logjikshëm dhe të kuptueshëm konform qëllimit të vizitës në shtetin tjetër. Mund të shkaktohet problem i madh ndërshtetëror nëse numri i anëtarëve të delegacionit do të ishte tepër i madh, që i jep mundësi dyshimi shtetit tjetër (veçanërisht kur marrëdhëniet shtetërore nuk janë miqësore). Shteti pranues mundet në çdo moment të refuzoj apo të ndalojë hyrjen në territorin e vet të secilit anëtarë të delegacionit, edhe atë pa qenë i obliguar që të jep arsytetime për një veprim të tillë.

Lehtësimet, privilegjet dhe imunitetet e çdo anëtari të misionit diplomatik special varen nga pozita dhe rangu i përbërjes së misionit. Nëse misionin e kryeson shefi i shtetit, shefi i qeverisë apo ministri i

punëve të jashtme ose ndonjë person tjetër i rangut të lartë, ai do t'i gëzojë privilegjet dhe imunitetet që atij i takojnë sipas normave të së drejtës ndërkombëtare.

Misionet speciale diplomatike

Misionet speciale kanë karakter të përfaqësimit diplomatik të një shteti në shtetin tjetër, apo të një shteti në ndonjë organizatë ndërkombëtare dhe anasjellë. Këta misioni zakonisht zgjasin për kohë të gjatë. Me nocionin mision special, nënkuptojmë misione të përkohshme të cilët një shtet i dërgon në një shtet tjetër apo në përfaqësinë e ndonjë organizate ndërkombëtare, me qëllim të shqyrtimit të një çështje apo problemi të caktuar dhe mundësisht të zgjidhjes së asaj çështje përmes bisedimeve. Misione të tilla konsiderohet edhe pjesëmarrja në ndonjë konferencë apo takim ndërkombëtar.

Zakonisht këso misionesh një shtet dërgon te një shtetet tjetër apo në selinë ose përfaqësinë e një organizate ndërkombëtare me qëllime të caktuara, siç mund të jenë zhvillimi i bisedimeve për probleme të ndryshme, realizimi i vizitave të niveleve të caktuara në shtetin tjetër, apo pjesëmarrja në ndonjë solemnitet ose manifestim të caktuar në shtetin tjetër apo në organizatën e caktuar ndërkombëtare.⁴⁰⁸ Si pjesë e këtij lloj misioni, delegacionet mund të zhvillojnë bisedime për çështje të ndryshme, si për shembull - për zhvillimin dhe avancimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mes shteteve (por, edhe me organizatat ndërkombëtare) në sfera të ndryshme të jetës politike, ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, sportive, ushtarake etj. Madje, delegacionet si pjesë e misionit special mund paraprakisht të përgatisin apo të realizojnë procedurën e lidhjes së

⁴⁰⁸ Misionet speciale, përveç se në bisedime, ata mund të marrin pjesë edhe në shumë manifestime tjera që mbahen në një shtet tjetër, siç mund të jenë – përfaqësimi i shtetit në solemnitetin e caktuar që mbahet në shtetin tjetër, siç mund të jetë kurorëzimi i mbretit të shtetit tjetër, inaugurimi i kryetarit të shtetit në shtetin tjetër, shpalljen e pavarësisë së një shteti, varrimin e shefit të shtetit apo të ndonjë personaliteti tjetër shtetërorë, komemoracioni etj.

marrëveshjeve të caktuara ndërkombëtare, nëse për këtë çështje janë të autorizuar nga shtetet e tyre.

Pra, fjala është për misione të cilët paraprakisht janë planifikuar vetëm për të shqyrtuar një çështje apo për detyra të caktuara, të cilat ndoshta në mes dy apo më shumë shteteve janë të kontestueshme, të paharmonizuara ose diskutabile. Apo është fjala për detyrë tjetër e caktuar e cila ka nevojë që të koordinohet bashkërisht me shtetin apo me shtete tjera me të cilat i lidhin interesa të përbashkëta.⁴⁰⁹

Pra, misioni special diplomatik nënkupton – dërgimin e delegacioneve të ndryshme shtetërore në shtetin tjetër për të shqyrtuar një çështje konkrete dhe pas kësaj të mund të bëhet kthimi i tyre në vendin e vet, pa kurrfarë pengese, pa marrë parasysh se a kanë përfunduar bisedimet me sukses apo të njëjtat janë në vazhdim, ose eventualisht të ketë ndodhur që bisedimet në mes delegacionit si mision special dhe përfaqësuesve të shtetit pranues të kenë dështuar tërësisht. Nëse çështja që është objekt shqyrtimi është tejet e rëndësishme, kurse shanset janë të mundshme që të arrihet ndonjë progres apo zgjidhje, misionin special mund ta kryesoj edhe shefi i shtetit. Këtu mbahet llogari që megjithatë të mos realizohen vizita të nivelit kaq të lartë nëse qysh përpara dihet se nuk do të ketë kurrfarë progresi, pasi në këtë mënyrë do të diskreditohej shefi i shtetit. Nivele të tilla të kontakteve dhe vizitave zyrtare mund të organizohen edhe me përfaqësuesit e ndonjë organizate ndërkombëtare, apo udhëtimi zyrtar në ndonjë konferencë ndërkombëtare.⁴¹⁰

⁴⁰⁹ Shih, Bilalli M, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, FON Universiteti, Shkup, 2008, f. 124; Po ashtu, Avramov S; Kreća M, ibid, str. 160.

⁴¹⁰ Kur shefat e shteteve udhëtojnë që të marrin pjesë në një konferencë ndërkombëtare, për shembull në seancat e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ata konsiderohen kryesues të misionit special diplomatik të shtetit të tyre. Përndryshe, një shef i shtetit nuk mund të shpallet persona non grata në shtetin tjetër ku edhe ka udhëtuar. Nëse ndodhë ndonjë incident diplomatik (për shembull, shefi i shtetit që kryeson misionin special në një shtet tjetër, të ketë ofenduar shefin e shtetit vendas apo shtetin e tij, atëherë ai pa u shpallur persona non grata, lutet që sa më shpejtë ta lëshojë territorin e shtetit ku ka udhëtuar.

Te misionet speciale duhet bërë dallimin në mes misioneve që kanë për qëllim komunikimin bilateral në mes subjekteve ndërkombëtare dhe atyre misioneve që kanë karakter multilateral. Sipas të drejtës diplomatike, misionet speciale bilaterale të një shteti mund të dërgohen në shtetin tjetër vetëm me pëlqim të atij shteti (pra, me marrëveshje reciproke në mes të dy shteteve). Megjithatë, te misioni me karakter multilateral, pra nëse misioni special i një shteti ka të bëjë me pjesëmarrjen e delegacionit të atij shteti në një konferencë ndërkombëtare (misioni special multilateral), në këto raste pa marrë parasysh marrëdhëniet ndërshtetërore me shtetin ku mbahet një takim i tillë, shteti pranues, pra shteti ku mbahet konferenca ka për obligim që delegacioneve të të gjitha shteteve t'u mundësojë lehtësime, privilegje dhe imunitete gjatë kohës së mbajtjes së konferencës dhe gjatë udhëtimit nëpër territorin e tij për të marrë pjesë në punën e konferencës apo takimit tjetër.

Pra, sikur të kemi situatë kur dy shtete nuk kanë aspak marrëdhënie diplomatike në mes veti apo të njëjtat i kanë të shkëputura, kurse në territorin e njërit shtet mbahet ndonjë konferencë ndërkombëtare apo mbahet ndonjë takim në selinë e një organizate ndërkombëtare e cila gjindet në territorin e atij shteti, atëherë pa marrë parasysh marrëdhëniet në mes këtyre dy shteteve, delegacioni i shtetit në fjalë ka të drejtë të merr pjesë në takime me të gjitha privilegjet dhe imunitetet e parapara për këto delegacione.

Sipas normave të së drejtës ndërkombëtare diplomatike, këtë obligim shteti pranues e ka madje edhe atëherë kur me shtetin tjetër si një ndër pjesëmarrësit në takimin multilaterale, nuk ka marrëdhënie diplomatike, apo është në gjendje të acaruar ose madje mund të jetë në gjendje lufte.⁴¹¹ Pra, shteti pranues nuk ka të drejtë të bëjë pengimin e pjesëmarrjes së delegacionit të atij shteti në konferencë. Po ashtu shteti pranues nuk ka të drejtë të pengojë as ardhjen e

⁴¹¹ Përderisa amerikanët luftonin kundër regjimit të diktatorit irakian Sadam Husein që pasoi pas invadimit të Irakut ndaj Kuvajtit në vitin 1991, përfaqësuesi irakian merrte pjesë në punën e organeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

delegacionit të shtetit tjetër të cilin shteti pranues nuk e ka njohur ndërkombëtarisht si shtet (si subjekt të së drejtës ndërkombëtare). E njëjta vlen edhe kur kemi situatë të kundërt, pra kur shteti i delegacionit nuk e ka njohur subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit të pranimit. Pjesëmarrja e delegacionit të shtetit të misionit special që nuk ka bërë njohjen ndërkombëtare të shtetit pranues, nuk nënkupton edhe njohje faktike të atij shteti.

Megjithatë, pa marrë parasysh faktin se këto misione speciale diplomatike kanë karakter të përkohshëm, ata konsiderohen si misione përfaqësuese diplomatike, pasi përfaqësojnë shefin e shtetit apo shtetin në bisedime me shtetet tjera apo me organizatat ndërkombëtare. Misionet speciale lirshëm mund të udhëtojnë edhe në shtetet tjera për takime me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, pa marrë parasysh se çfarë marrëdhënies ekzistojnë në mes shtetit të delegacionit ad hoc dhe shtetit ku gjendet selia e organizatës së caktuar ndërkombëtare.⁴¹² Kështu, për shembull, presidenti peruan Hugo Çavez, përkundër marrëdhënies tepër të acaruar në mes Perusë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pa probleme kishte udhëtuar në selinë e organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork dhe gjatë diskutimit të tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB, Çavez, kryetarin amerikan Xhorxh Bush e kishte quajtur “satana i botës.”⁴¹³ Natyrisht, se qeveria amerikane nuk kishte të drejtë që Çavezin ta shpallë persona non grata (person të padëshiruar).⁴¹⁴

⁴¹² Bilalli M, Ibid, f. 124.

⁴¹³ Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kishin të drejtë Çavezin ta shpallin “persona non grata”, kur ai në vitin 2008 gjatë diskutimit që ai bërë në selinë e OKB-së rëndë pat ofenduar kryetarin amerikan. Në fakt, Kombet e Bashkuara kanë lidhë marrëveshje me SHBA, sipas të cilës parashihen lehtësime, privilegje dhe imunitete për përfaqësuesit e shteteve anëtare të cilat marrin pjesë në punën e organeve të OKB-së, pra në selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shih, Bilalli M, Ibid, f. 124 dhe f. 134.

⁴¹⁴ Shpallja e ndonjë diplomati apo përfaqësuesi shtetëror të huaj si persona non grata, nënkupton që ai diplomat duhet brenda afatit sa më të shkurtër ta lëshojë territorin e shtetit pranues.

Nga e gjithë kjo, si konstatim mund të nxjerrim se misionet diplomatike speciale paraqiten si faktorë tejet të rëndësishme në komunikimin diplomatik ndërkombëtar, pasi përmes formave të ndryshme të organizimit dhe funksionimit të tyre misioneve speciale diplomatike, mundësohet vënie komunikimi në mes palëve të konfrontuara madje edhe në situatat më të komplikuar dhe më të tendosura në mes shteteve të ndryshme, qoftë edhe me ndonjë shtet që qartë ka shkelur normat e të drejtës ndërkombëtare. Pra, këto misione mundësojnë realizimin e komunikimit diplomatik në formën më plastike dhe më fleksibile në mes përfaqësuesve të shteteve të cilat ndeshen me probleme apo konfrontime në mes veti.

Kjo është e nevojshme pasi, edhe më tej jemi dëshmitar të ambientit politik në botë ku shtetet e ndryshme të botës moderne dhe bashkësia ndërkombëtare si tërësi, vazhdojnë akoma të jenë të ngarkuar me shumë probleme, me shumë konteste dhe konflikte të natyrave të ndryshme, duke përfshi edhe ata ushtarake.⁴¹⁵ Nisur nga këto realitete, si dhe nga nevoja për tejkalimin apo zgjidhjen e situatave të tendosura, gjendjeve të acaruar, apo konflikteve të ndryshme, është i preferueshëm komunikimi diplomatik i balancuar dhe i matur me qëllim të tejkalimit sa më të lehtë të këtyre situatave.

Statusi juridik i misioneve diplomatike speciale

Çështjen e statusit juridik ndërkombëtar të misioneve speciale e rregullon *Konventa për misionet speciale* e viti 1969. Në te përfshihet kodifikimi i normave juridike ndërkombëtare të ndërtuara si norma të së drejtës zakonore, të cilat kanë pasur të bëjë me *ad hoc* vizitat e delegacioneve të ndryshme shtetërore në shtetet tjera, vizitat në organizatat ndërkombëtare apo takime në konferenca të ndryshme ndërkombëtare. Këto norma juridike kanë tanguar *ad hoc* takimet si në nivel bilateral ashtu edhe në atë multilateral.⁴¹⁶ Pra.

⁴¹⁵ Avramov S, Kreća M, Ibid, str. 160.

⁴¹⁶ Bilalli M, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, universiteti FON, Shkup, 2008, f. 125.

këtu përfshihen edhe vizitat dhe takimet që realizohen në të gjitha organizatat ndërkombëtare, duke përfshi edhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Natyrisht se konventa e përmendur nuk përfshinë të gjitha detajet që kanë të bëjnë me misionet speciale. Kështu që për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me situata dhe veprime të caktuara të misioneve speciale diplomatike, të cilat nuk janë të përfshira në rregullativën juridike normative në kësaj konvente, sigurisht se edhe më tej vlejné normat e së drejtës zakonore në sferën e kësaj veprimtarie diplomatike.

Normat e *Konventës mbi Misionet Speciale* (1969), më tepër kanë karakter dispozitiv, që nënkupton se palët⁴¹⁷ marrëdhëniet në mes tyre mund t'ua adaptojnë situatave konkrete dhe specifikave të caktuara konform nivelit të marrëdhënieve ndërshtetërore që kanë mes veti. Në nenin 3 të Konventës mbi Misionet Speciale theksohet: “funktioni i misioneve speciale përcaktohet me harmonizim të përbashkët në mes shtetit dërgues dhe shtetit pranues.”

Konventa mbi Misionet Speciale - misionet speciale i definojnë si mision i përkohshëm, i cili përfaqëson shtetin, i cili udhëton në shtetin tjetër, në pajtueshmëri në mes veti, me qëllim të zhvillimit të bisedimeve në mes veti për çështje të caktuara apo për kryerjen e detyrës së caktuar. Në këtë definicion nuk përmenden organizatat ndërkombëtare. Kështu që, gjër me miratimin e *Konventës së Vienës për përfaqësimin e shteteve në marrëdhëniet e tyre me organizatat ndërkombëtare me karakter universal* (1975), vlenin koglomerat të normave juridike zakonore dhe disa normave të shkruara.

Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të drejtë ndërkombëtare - i udhëhequr nga nevojat pragmatike, misionin diplomatik ad hoc e definojnë si - mision special në ndonjë konferencë ndërkombëtare apo në ndonjë vizitë ndërshtetërore, apo në ndonjë takim të caktuar, ose në pjesëmarrje në ndonjë ceremonial. Pra, Komisioni në

⁴¹⁷ Në të drejtën diplomatike palë konsiderohen shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, apo ndonjë takim tjetër ndërkombëtar i institucionalizuar (konferencë, kongres etj.).

definicionin e vet kishte përfshirë edhe sistemet dhe rregullat të cilat kanë të bëjnë me organizatat ndërkombëtare. Zakonisht takimet e mëdha ndërkombëtare mbahen nën patronatin juridik të ndonjë organizate ndërkombëtare, të cilat në të shumtën e rasteve disponojnë me dispozita të standardizuara.⁴¹⁸ Këto rregulla të standardizuara kanë të bëjnë me të gjitha çështjet - me të drejtat dhe obligimet e shteteve dhe përfaqësuesve të tyre, me lehtësimet, me imunitetet dhe privilegjet e delegacioneve të cilat marrin pjesë në punën e konferencës apo të ndonjë takimi tjetër multilateral ndërkombëtar.

Megjithatë, duhet potencuar se materia e misioneve speciale, sidomos ajo që ka të bëjë me organizatat dhe konferencat ndërkombëtare, është në ndërtim të vazhdueshëm, kështu që do të nevojitet edhe një kohë që e gjithë kjo materie të shndërrohet në praktikë përgjithësisht të akceptuar.

Karakteristikat e misioneve speciale bilaterale

Pa dilemë se edhe misionet speciale kanë karakter të përfaqësimit të një shteti në shtetin tjetër apo përfaqësim të një shteti në ndonjë konferencë ndërkombëtare ose në ndonjë organizatë ndërkombëtare. Zakonisht misionet speciale nuk zgjatin shumë kohë, pasi ata përfundojnë me kryerjen e detyrës konkrete apo me kalimin e kohës së caktuar, pa marrë parasysh rezultatet e vizitës apo takimit. E njëjta gjë vlen edhe për misionin special bilateral (të dyanshëm). Sipas Konventës mbi Misionet Speciale të vitit 1969, misionet speciale bilaterale i kanë këto karakteristika:

- misioni special dërgohet nga një shtet në shtetin tjetër me pëlqim të përbashkët të dy shteteve;
- misioni special përfaqëson shtetin dërgues te shteti pranues;

⁴¹⁸ Shih, përmbledhje të dispozitave në edicion të OKB: Law and Regulations regarding Diplomatic and Consular privileges and Immunities. Legislative Series, vol.7.

- kohëzgjatja e vizitës së misionit special në shtetin tjetër është e kufizuar dhe përcaktohet në bazë të marrëveshjes në mes të dy shteteve;

- misioni special ka për detyrë diskutimin, shqyrtimin apo nënshkrimin e ndonjë çështje apo detyre konkrete;

- vizita e misionit special nuk ka për detyrë ekzistimin e marrëdhënieve të përgjithshme diplomatike në mes dy shteteve.

Që të mund të realizohet vizita e një delegacioni të misionit special të një shteti në një shtet tjetër, është e domosdoshme marrëveshja në mes të dy shteteve (apo pëlqimi i tyre). Këtu duhet potencuar se për realizimin e vizitës së një delegacioni shtetëror të një shteti në shtetin tjetër, procedura nuk është aspak e komplikuar nëse marrëdhëniet në mes dy shteteve, pra shtetit dërgues dhe shtetit pranues janë miqësore. Por, kjo nuk vlen edhe për situatat kur marrëdhëniet ndërshtetërore në mes dy shteteve nuk janë aq të mira, apo janë të tendosura dhe tepër të acaruar. Zakonisht në këso situatash dhe rastesh, shteti pranues lyp shumë të dhëna në detaje për çdo anëtarë të delegacionit, vërtetësinë e të cilave e provon përmes mekanizmave të veta shtetërore. Pra, kur në mes të dy shteteve nuk ekzistojnë marrëdhënie të mira apo nuk ekziston mirëbesim reciprok, realizimi i vizitës është shumë i komplikuar.⁴¹⁹

Numri i anëtarëve të delegacionit në kuadër të misionit special zakonisht përcaktohet me marrëveshje në mes shtetit dërgues dhe shtetit pranues. Zakonisht shteti dërgues për numrin e anëtarëve dhe për përbërjen e misionit special informon organet e shtetit pranues. Kjo çështje mund të realizohet edhe me marrëveshje reciproke në mes shteteve. Delegacioni duhet të jetë në numër të logjikshëm dhe të kuptueshëm konform qëllimit të vizitës në shtetin tjetër. Mund të

⁴¹⁹ Në këto raste, shtetet të cilat nuk kanë nivel të mirë të marrëdhënieve diplomatike në mes veti apo të marrëdhënieve tjera ndërshtetërore, më së tepërmi kanë kujdes për atë që në kuadër të anëtarëve të delegacionit oficial shtetëror (misionit special) të mos ketë personalitete që mund të merren edhe me veprimtari informative, të spiunimit, apo kundërzbulimit.

shkaktohet problem i madh ndërshtetëror nëse numri i anëtarëve të delegacionit do të ishte tepër i madh, që i jep mundësi dyshimi shtetit tjetër (veçanërisht kur marrëdhëniet shtetërore nuk janë miqësore), se vizita ndoshta ka edhe ndonjë qëllim tjetër. Shteti pranues mundet në çdo moment të refuzoj apo të ndalojë hyrjen në territorin e vet të secilit anëtarë të delegacionit, madje pa qenë i obliguar që të jep arsytetime për një veprim të tillë.

Për dallim nga misionet e përhershme diplomatike, ku që të mund të ushtrohet funksioni diplomatik në shtetin pranues, për shefin e misionit diplomatik është e nevojshme dhënia e agrementit⁴²⁰ nga ana e shtetit pranues, te misionet speciale nuk është e nevojshme një gjë e tillë. Pra, për udhëheqshin e delegacionit special (kryesuesin e misionit special diplomatik), shteti i pranimit nuk duhet të jep agrement. Po ashtu, në këso vizitash nuk bëhet as dorëzim i letrave kredenciale te shefi i shtetit të pranimit.⁴²¹ E gjithë procedura realizohet përmes notifikimit të shtetit tjetër për strukturën organizative të delegacionit të shtetit dërgues.

Konventa mbi Misionet Speciale, përmban dispozita konkrete dhe të precizuara në lidhje me notifikimin e organeve të shtetit tjetër. Zakonisht, notifikimi përmban datën e fillimit të vizitës dhe të përfundimit të saj, përbërjen dhe strukturën e misionit special bilateral diplomatik, lokacionet e qëndrimit dhe veprimit të tij, numrin e anëtarëve të delegacionit dhe statusin e tyre. Notifikimi i dërgohet ministrisë për punë të jashtme të shtetit pranues.⁴²²

⁴²⁰ Agrementi është njëfarë pëlqimi i dhënë nga ana e shtetit pranues, për atë se shefi i ardhshëm i misionit të përhershëm diplomatik të shtetit dërgues i akredituar te shteti pranues, mund të kryesojë misionin e vet të përhershëm diplomatik.

⁴²¹ Te përfaqësitë e përhershme diplomatike, dhënia e agrementit nga ana e shtetit pranues është çështje vendimtare që përfaqësuesi diplomatik (pra, shefi i misionit diplomatik) i shtetit dërgues të ushtrojë funksion diplomatik te shteti pranues. Pra, në këtë rast dhënia e agrementit për të ushtruar funksionin diplomatik ka karakter obligativ. Po ashtu, te misioni diplomatik i përhershëm, obligim juridik është edhe dorëzimi i letrave kredenciale te shefi i shtetit të pranimit, pasi nga ky moment konsiderohet se ai ka filluar ushtrimin e funksionit diplomatik.

⁴²² Shteti dërgues përmes notifikimit informon shtetin pranues për të gjitha ndryshimet eventuale që mund të ndodhin në delegacion, siç mund të jetë për

Shteti pranues në çdo kohë ka mundësi që ta informojë shtetin dërgues për atë se ndonjëri nga anëtarët e delegacionit është shpallur person i padëshiruar (*persona non grata*), dhe për këtë nuk ka obligim që të jep arsyetim. Në këto raste, anëtari i delegacionit që është shpallur si *persona non grata* duhet që sa më shpejtë ta lëshojë territorin e shtetit pranues.

Lehtësimet imunitetet dhe privilegjet te misionet speciale

Lehtësimet, privilegjet dhe imunitetet e çdo anëtari të misionit diplomatik special varen nga pozita dhe rangu i përbërjes së misionit. Nëse misionin e kryeson shefi i shtetit, shefi i qeverisë apo ministri për punë të jashtme ose ndonjë person tjetër i rangut të lartë, ai do t'i gëzojë privilegjet dhe imunitetet që atij i takojnë sipas normave të së drejtës ndërkombëtare. Pra, kur delegacionin e misionit special e udhëheq shefi i shtetit, premieri apo ministri për punë të jashtme, këto persona pos privilegjeve dhe imuniteteve të parapara nga *Konventa mbi Misionet Speciale* (1969), gjithashtu gëzojnë edhe privilegje dhe imunitete tjera të parapara nga e drejta ndërkombëtare. Kurse për anëtarët e rangut më të ulët të misionit special janë të mjaftueshme dispozitat e *Konventës mbi Misionet Speciale*.

Misioni special ka selinë e vet, pra lokalitetet ku qëndron delegacioni me të gjitha shërbimet e duhura e cila përcaktohet me marrëveshje të përbashkët në mes organeve kompetente të të dy shteteve. Në selinë e misionit diplomatik mund të vendoset flamuri dhe stema e shtetit të cilit i takon misioni special. Lokalitetet ku është duke qëndruar delegacioni i misionit special janë të pacenueshme dhe të mbrojtura. Shteti pranues ka për obligim që të bëjë sigurimin dhe mbrojtjen e objektit ku është i vendosur misioni special diplomatik. Ai ka përgjegjësi për çdo incident që mund të ndodhë nëse

shembull ndërrimi i shefit të delegacionit dhe zëvendësimi i tij me ndonjë tjetër; lëshimi para kohe i shtetit pranues nga ndonjë anëtar i delegacionit; tërheqja apo revokimi e ndonjë anëtari nga ana e shtetit dërgues etj.

sigurimi nuk ka qenë në nivelin e duhur. Në këto lokalitete, organet apo shërbimet e ndryshme të shtetit pranues mund të hyjnë vetëm me thirrjen apo lejen e shefit të misionit special.⁴²³

Në rast të fatkeqësive elementare, siç mund të jenë – eksplozimet, zjarret, tërmetet, rrëzimi i objektit apo rreziqe tjera që mund të ndodhin në objektin apo rreth tij me pasoja të rrezikshme, nëse këtë e kërkon urgjenca, organet e vendit mund të hyjnë në objekt për sanimin e gjendjes dhe në këso rastesh supozohet se leja është dhënë nga ana e shefit të misionit special diplomatik, me kusht që për shkak të fatkeqësisë së caktuar të ketë qenë e pamundur që paraprakisht të sigurohet leja nga përfaqësuesi i misionit special.

Gjithashtu, objekti dhe brendia e tij ku qëndron misioni special diplomatik nuk mund t'i nënshtrohet kurrfarë kontrolli nga ana e organeve të vendit. Njëkohësisht arkivi dhe dokumentacioni tjetër që i takojnë delegacionit të misionit special diplomatik është i paprekshëm, pa dallim se ku gjendet, me kusht që ky dokumentacion të ketë shenjë e nevojshme me të cilën dëshmohet se ai arkiv apo ato dokumente i takojnë misionit special diplomatik.

Gjithashtu, shteti pranues ka për obligim që të ofron lehtësime të natyrës së ndryshme me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të detyrës së caktuar të misionit special diplomatik. Shteti pranues, po ashtu ka për obligim që të ofron çfarëdo ndihme të nevojshme që kërkohet nga ana e misionit special diplomatik, e që ka për qëllim realizimin sa më të suksesshëm të vizitës së tij.⁴²⁴ Këtu në veçanti

⁴²³ Në të kaluarën, përfaqësitë diplomatike në shtetin tjetër gëzonin eksteritorialitet. Kjo nënkuptonte regjim të atillë sa përfaqësia diplomatike e një shteti konsiderohej si pjesë e territorit të shtetit akreditues të cilit i takonte përfaqësia diplomatike. Kjo vlente për kohën kur konsiderohej se përfaqësuesi diplomatik përfaqëson shefin e shtetit të shtetit pranues. Tani kjo teori është e vjetërsuar, pasi përfaqësuesi diplomatik përfaqëson vetëm shtetin e vet, por jo edhe shefin e shtetit të vet. Kurse misioni diplomatik nuk gëzon më eksteritorialitet, por paprekshmëri. Të drejtën e azilit që kanë mundur ta japin përfaqësitë diplomatike është nxjerrë nga eksteritorialiteti. Shih, Genet R, *traite de diplomatie et de droit diplomatique*, I, p. 422.

⁴²⁴ Të siguroj lidhje të nevojshme për komunikim, ndihmë prioritare në përmirësimin e kushteve të punës, mundësimin e sigurimit të mjete transportuese etj.

duhet përmendur sigurimin e lokaliteteve adekuate për banim dhe punë. Pastaj sigurimin e komunikimit adekuat duke përfshi edhe korrierët, përdorimin e shifrave dhe kodeve për komunikim në mes veti, me organet e shtetit të vet apo me organet e shteteve tjera. Në kushte të ekzistimit të reciprocitetit në mes shtetit dërgues dhe shtetit pranues, këto shërbime mund të bëhen edhe falas, pra pa kompensim.

Posta diplomatike zyrtare po ashtu është e paprekshme. Për komunikim sa më efikas delegacioni i misionit special mund të shfrytëzojë edhe korrierët dhe valizën diplomatike. Valiza diplomatike nuk i nënshtrohet kontrollimit nga ana e organeve të shtetit të pranimit, përveç nëse ekziston dyshim shumë i bazuar se në te gjinden sende të palejueshme.⁴²⁵

Pa dilemë se edhe anëtarët e misionit special diplomatik gëzojnë imunitet të plotë diplomatik konform normave të së drejtës ndërkombëtare. Ata gëzojnë imunitet penal, civil, policor, administrativ dhe fiskal. Pra, ata nuk mund të arrestohen, burgosen apo të mbahen dhe ndalohen para organeve policore e gjyqësore të shtetit vendas, pa marrë parasysh se çfarë vepre penale mund të kenë kryer. Në këso rastesh veprimi më i ashpër i shtetit pranues mund të jetë shpallja e kryesit *persona non grata* dhe kërkesa që brenda një afati sa më të shkurtër apo të fiksuar anëtari i delegacionit të misionit special diplomatik ta lëshon territorin e shtetit pranues. Anëtari i misionit special diplomatik nuk ka të drejtë që vullnetarisht të heq dorë nga imuniteti penal, pra ai nuk ka të drejtë që vullnetarisht të heq dorë nga ky lloj imuniteti dhe të paraqitet para organeve kompetente penale të shtetit vendës. Por, kjo nuk vlen edhe për imunitetin civil.

Personeli diplomatik në kuadër të misionit special diplomatik gjithashtu gëzon edhe imunitet civil, që nënkupton se ai nuk mund t'i nënshtrohet procesit gjyqësor në lidhje me çështjet civilo-juridike jashtë vullnetit të tij. Megjithatë, nëse është në pyetje procedura në

⁴²⁵ Në praktikën diplomatike kemi pasur shumë raste kur diplomatët e kanë keqpërdorur valizën diplomatike, duke mbajtur në te mjete të ndaluara nga ligjet e shtetit të pranimit (tregtia me sende të ndaluara, mjete narkotike, armë ilegale etj.).

lidhje me pasurinë e tyre private në shtetin pranues, personi diplomatik vullnetarisht mund të heq dorë nga imuniteti civil dhe të paraqitet para gjykatës së shtetit pranues. Por, edhe në këto raste, ndaj personave diplomatik sjellja e organeve vendas duhet të jetë me respekt të plotë.

Edhe sa u përket çështjeve fiskale anëtarët e misionit special gëzojnë imunitet, që nënkupton përjashtim të anëtarëve të misionit nga pushteti fiskal i shtetit pranues. Misioni special diplomatik është i përjashtuar nga pagimi i çfarëdo taksave dhe tatimeve shtetërore, rajonale apo komunale në shtetin pranues. Po ashtu, anëtarët e misionit special diplomatik janë të liruar edhe nga pagimi i doganës në shtetin pranues.

Sipas të drejtës ndërkombëtare, imunitet penal gëzojnë edhe personeli teknik dhe administrativ i misionit special diplomatik.⁴²⁶ Personel i tillë konsiderohen personat që e përcjellin delegacionin e misionit special diplomatik dhe të njëjtit i ofrojnë shërbime teknike dhe administrative (sekretarët e ndryshëm, administratorët, daktilografistët, korrierët etj.). Megjithatë, sa i përket imunitetit civil, këta nuk janë të barabartë me anëtarët e misionit special që kanë status diplomatik. Kështu që në raste të caktuar personat teknik apo administrativ përcjellës të delegacionit mund t'i nënshtrohen procedurës civile para organeve vendas (si të paditur apo si dëshmitarë për çështje juridiko-civile).

Personeli shërbyes⁴²⁷ që përcjell misionin special diplomatik gëzon imunitet penal vetëm gjatë ushtrimit të detyrës së vet që është e lidhur për punën dhe funksionimin e misionit. Jashtë saj ata nuk gëzojnë imunitet penal. Ata po ashtu janë të liruar nga pagimi i tatimit dhe të dhënave tjera lidhur me sigurimin social në shtetin e pranimit.

⁴²⁶ Personel teknik e administrativ konsiderohen – sekretarët apo sekretaret, daktilografistët, telefonistët dhe mbajtësit e lidhjeve tjera, personeli për sigurim etj.

⁴²⁷ Si personel shërbyes konsiderohen - pastruesit, kuzhinierët, bartësit e bagazhit etj.

Sipas *Konventës për Misionet Speciale* dhe dispozitave tjera, imunitete dhe privilegje gëzojnë edhe anëtarët e familjeve të pjesëtarëve të misionit diplomatik, por vetëm nëse:

a) janë përcjellës të delegacionit, e jo në vizitë private të ndarë nga protokollu i delegacionit, dhe

b) nëse nuk janë shtetas të shtetit pranues apo nuk kanë vendqëndrim të rregullt në shtetin pranues.

Nëse këta persona janë shtetas të shtetit pranues, atëherë statusi i tyre dukshëm ndryshon, sidomos sa i përket imunitetit civil dhe fiskal, kështu që sipas të drejtës diplomatike ata juridikisht dhe praktikisht i nënshtrohen juridiksionit civil dhe penal të shtetit pranues.

Përfundimi i misionit special diplomatik

Vizitat e misioneve speciale diplomatike zakonisht nuk zgjatën shumë sa i përket aspektit kohor. Rregullisht, misioni special diplomatik përfundon misionin e vet me skadimin e afatit të paraparë për realizimin e vizitës, apo nëse paraprakisht ka qenë paraparë që misioni special diplomatik të zgjatë gjer me kryerjen e punës dhe detyrës së paraparë, e cila njëherit ka qenë edhe qëllim i një vizite të tillë, atëherë misioni special përfundon vizitën e vet me kryerjen e asaj detyre. Por, në çdo rast palët mund vet të vendosin për mënyrën, metodologjinë dhe kohëzgjatjen e bisedimeve, kështu që vet palët biseduese kanë mundësi aty për aty të merren vesh se a do të vazhdojnë edhe më tej me bisedimet, apo do të bëjnë pauzë me qëllim të konsultimeve shtesë, ose do të vendosin që t'i ndërpresin bisedimet pasi pozicionet në mes veti i kanë shumë të larguara. Në fakt vet palët, pra shteti dërgues dhe shteti pranues vendosin për kohëzgjatjen e qëndrimit të misionit special diplomatik në territorin e shtetit pranues. Në raste të caktuara, vizita e misionit special diplomatik mund të përfundojë edhe para skadimit të kohës së paraparë, edhe atë:

- nëse konstatohet se nuk ka disponim që të vazhdohen më tej bisedimet në mes delegacioneve të shtetit dërgues dhe atij pranues;
- nëse njëra palë lyp kohë shtesë për të realizuar konsultime plotësuese me organet e shtetit të vet;
- nëse në ndërkohë dukshëm janë acaruar marrëdhëniet ndërshtetërore në mes shtetit pranues dhe shtetit dërgues;
- nëse ndërpriten bisedimet;
- nëse një anëtar i misionit apo i gjithë misioni special shpallen si të padëshiruar (persona non grata).

Konkluzioni

Te misionet speciale duhet bërë dallimin në mes misioneve bilateral dhe atyre multilateral. Sipas të drejtës diplomatike, një shtet mund të dërgoj mision speciale në shtetin tjetër vetëm me pëlqim e atij shteti. Kurse te misioni multilateral, pra nëse misioni special i një shteti ka të bëjë me pjesëmarrjen e delegacionit të atij shteti në një konferencë ndërkombëtare (misioni special multilateral), atëherë pa marrë parasysh marrëdhëniet ndërshtetërore në mes shtetit ku mbahet një takim i tillë dhe shtetit dërgues, parimisht delegacionit nuk mund t'i ndalohet udhëtimi, pjesëmarrja dhe gëzimi i të gjitha lehtësimeve, privilegjeve dhe imunitete që i takojnë delegacionit gjatë mbajtjes së konferencës. Pra, madje sikur këta dy shtete të mos kenë aspak marrëdhënie diplomatike në mes veti apo të njëjtat i kanë të shkëputura, kurse në territorin e njërit shtet mbahet ndonjë konferencë ndërkombëtare apo ndonjë takim në selinë e një organizate ndërkombëtare e cila gjendet në territorin e atij shteti, atëherë pa marrë parasysh marrëdhëniet në mes këtyre dy shteteve, delegacioni i shtetit në fjalë ka të drejtë të merr pjesë në takime me të gjitha privilegjet dhe imunitetet e parapara për këto delegacione.

Conclusion

To the special missions should be a distinction between bilateral and multilateral missions. According to diplomatic law, a state may send a special mission to another country only with the consent of that state. But the multilateral mission, so if the special mission of a state is related to the participation of that state's delegation to an international conference (special mission multilateral), then regardless of interstate relations between the state where such a meeting is held and the receiving state, principle can not be excluded delegation travel, participation and enjoyment of all the facilities, privileges and immunities belonging to the holding of the conference delegation. So, even though these two countries have not diplomatic relations at all each other or have the same detached, while in the territory of one state held an international conference or a meeting at the headquarters of an international organization which is located in the territory of that state, then no matter the relationship between these two countries, the delegation of the State concerned has the right to take part in meetings with all the privileges and immunities provided for these delegations.

Literatura

- G.V. McClanahan, Diplomatic Immunity, Principles, Practices, Problems, New York, 1989
- Satow, s Guide, To Diplomatic Longman, 1973
- J. Andrassy, Medjunarodno pravo, Zagreb 1998
- Historija Diplomacije, Prvi svezak ured. V.P. Potemkina, Matica Hrvatske, Zagreb, 1951
- Hugo Grotius, The Law of War and Peace, Indianapolis, New York, 1925
- Z. Gruda, E drejta nderkombetare publike, Prishtine, 2004

- Frckovski, Tupurkovski, Ortakovski, Medjunarodno javno pravo, Skopje, 1995
- M. Bilalli, E drejta nderkombetare publike, FON, 2008
- M. Bilalli, E drejta diplomatike dhe konsullore (skripta), FON, 2011
- Vienna Convention on Diplomatic Relations, US Treaties and other International Acts, US Government Printing Office, Washington D.C.
- Convention on Special Missions, United Nations, New York, 1969
- Vienska konvencija o diplomatskim odnosima, Viena, 1961